



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 72 Prot.

Tiranë, më 09 . 01 .2025

V E N D I M

Nr. 13, Datë 09 . 01 . 2025

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është paraqitur ankesa nr. 250 regi., datë 04.12.2024, e znj. E. L kundër Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar (ZVAP) Lushnjë, Bashkisë Lushnjë dhe Drejtorit të gjimnazit “Jani Dani” Lushnjë, në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “gjinisë”.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna në formularin e ankesës, subjekti ankues, znj. E. L, ka parashtruar se:

“Jam prej 6 vitesh drejtuese në institucionin arsimor 9-vjeçar “Mihal Davidhi” Gorre, Lushnjë. Më datë 30.10.2024, në orën 09:12 mora një telefonatë nga drejtuesja e ZVAP Lushnjë, për tu paraqitur në ZVAP. Në takim, drejtuesja e ZVAP-së më komunikoi se Ministria e Arsimit dhe Sportit ka sjellë shkresën për mbylljen e shkollës 9-vjeçare “Mihal Davidhi” ku aktualisht unë jam drejtuese, dhe gjimnazit “Pali Dani”, me drejtues z. A. N, si dhe hapjen e institucionit arsimor “Shkolla e Bashkuar Gorre”. Në shkollën ku unë jam drejtuese ruhet numri i nxënësve, ndërsa në gjimnazin “Pali Dani” ka vite që nuk ruhet numri i nxënësve dhe duhej të ishte mbyllur vite më parë. E gjithë kjo bëhet që të më spostojnë mua e të mbajnë drejtorin z. A. N, që me dije të plotë qëndron ende drejtues, mbështetur fuqishëm nga ZVAP Lushnjë dhe Bashkia Lushnjë.”

Kërkova nga drejtuesja e ZVAP Lushnjë që të njihem me shkresën që ZVAP-ja dhe Bashkia Lushnjë i kishin dërguar MAS.

Pasi u njoha me shkresën me nr. 1147 prot., datë 11.07.2024, konstatova që ky proces ka filluar që në muajin maj, sipas kërkesës së depozituar në ZVAP nga drejtuesi i gjimnazit “Pali Dani”, Lushnjë (shkresa me nr. 526 prot., datë 09.05.2024) dhe vetëm me datë 29.07.2024 mora telefonatë nga drejtuesja e ZVAP-së, ku duhet të njoftoja mësuesit e shkollës për dëgjesën që do të zhvillohej në datën 30.07.2024, në ambientet e gjimnazit “Pali Dani”.

Sipas e-mailit të datës 25.11.2024, të ZVAP-së, duhet të njoftoja këshillin e mësuesve, prindërve, bordin e shkollës dhe senatin, për të zgjedhur organet kolegjiale të “Shkollës së Bashkuar Gorre”.

Bashkëlidhur e-mailit ishte dhe Urdhri i ZVAP Lushnjë, ku cilësohej shpallja e vendit vakant, bërë nga DRAP Fier, në faqen zyrtare, për të cilën duhet të njoftohesha zyrtarisht, gjë që nuk ka ndodhur. Vazhdon padrejtësia me cilësimin në shkresën e ZVPA Lushnjë dhe Bashkisë Lushnjë, në pikën G, të së cilës shkruhet: “Drejtuesi i insitucionit arsimor, gjimnazit “Pali Dani” plotëson kriteret sipas Udhëzimit nr. 22, datë 13.11.2023, ku për këtë cilësim ka kompetencë vetëm DRAP Fier. Po drejtuesi i insitucionit shkollës 9-vjeçare “Mihal Davidhi”?

Vërehen qartë shkelje të afateve dhe procedurave, duke cenuar transparencën e këtij procesi.”

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi: “Të qëndroj në pozicionin aktual drejtuese e institucionit, rivendosjen në vend të dinjitetit dhe personalitetit tim nga ZVAP Lushnjë, Bashkia Lushnjë dhe Drejtoria e gjimnazit “Pali Dani”, Lushnjë. Të pezullohen të gjitha procedurat pasi janë antiligjore.”

Pas regjistrimit të ankesës së depozituar pranë Komisionerit, u konstatua se ajo kishte mangësi të anës formale, në lidhje me dokumentacionin provues lidhur me provueshmërinë e disa prej deklarimeve të bëra prej saj kundrejt subjekteve të paditura.

Për këtë arsye, nëpërmjet e-mailit datë 16.12.2024, nga ana e inspektorit të çështjes është proceduar me kërkesën për plotësimin¹ e dokumentacionit e informacionit të nevojshëm për vijimin e shqyrtimit të ankesës së saj.

¹ Parashtrimet tuaja lidhur me pretendimin për diskriminim nga ana e ZVAP Lushnjë, dhe lidhjen me shkakun e pretenduar;

Parashtrimet tuaja lidhur me pretendimin për diskriminim nga ana e Bashkisë Lushnjë, dhe lidhjen me shkakun e pretenduar;

Parashtrimet tuaja lidhur me pretendimin për diskriminim nga ana e Drejtorit të Gjimnazit “Pali Dani”, dhe lidhjen me shkakun e pretenduar;

Kopje të dokumentacionit të dorëzuar prej jush, lidhur me aplikimin për pozicionin e cituar (Drejtorit në SHMB)

Kopje të ankesave tuaja drejtuar institucioneve perkatëse, nese keni.

Nese po, kopje të kthim pergjigjeve/korrespondences se mbajtur me to, nese keni.

Si dhe cdo prove qe vleresoni se verteton pretendimet tuaja.”

Nëpërmjet e-mailit datë 23.12.2204, ankuesja ka kërkuar ti lihet afat për plotësimin e dërgimin e dokumentacionit dhe sqarimeve të kërkuara nga KMD.

Nëpërmjet e-mailit datë 07.01.2025, ankueses i është dërguar sërish një kujtesë për plotësimin e dokumentacionit të kërkuar.

Znj. L nuk iu përgjigj kërkesave të KMD-së, lidhur me sqarimet e dokumentacionin e kërkuar. Në këto kushte, për shqyrtimin e ankesës, Komisioneri është bazuar në analizimin e dokumentacionit e parashtrimeve të depozituara nga subjekti ankues në ankesën me nr. 250 regj., datë 05.12.2024.

II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës u konstatua se:

Në nenin 1 të ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”*.

Diskriminimi përkufizohet nga ligji 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, në nenin 3, pika 1, si: *“‘Diskriminim’ është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”*.

Në bazë të nenit 7, të ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprim të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Mbështetur në detyrimet ligjore të parashikuara në nenin 3 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë në të cilën shteti merr masa për mbrojtjen e dinjitetit të njeriut dhe respektimin e lirive dhe të drejtave të tij, nenit 14 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, ligjin nr. 10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi synon respektimin me rigorozitet të parimit të barazisë përpara ligjit, barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat dhe liritë, si dhe zbatimin e efektshëm të politikave antidiskriminuese.

Nga shqyrtimi paraprak i dokumentacionit të depozituar nga ankuesja, si dhe referuar kronologjisë së ngjarjeve të pasqyruara në këto akte, Komisioneri konstaton se:

- Me shkresën me nr. 526 prot., datë 09.05.2024², gjimnazi “Pali DaniI” Lushnjë³, ka informuar ZVAP Lushnjë për rënien e numrit të nxënësve dhe ka kërkuar bashkimin e institucioneve arsimore sipas formave të lejuara ligjore.
- Me datë 11.07.2024, anë të një shkrese të përbashkët ZVAP Lushnjë⁴ dhe Bashkia Lushnjë, me lëndë: *“Kërkesë për bashkim institucionesh arsimore, gjimnazit “Pali Dani” dhe shkollës 9-vjeçare “Mihal Davidhi” Gorre, Lushnjë, në formën e shkollës së bashkuar”,* i janë drejtuar Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, lidhur me kërkesën për marrjen në shqyrtim nga ana e saj, të bashkimit të këtyre dy institucioneve arsimore në shkollë të bashkuar, duke paraqitur edhe argumentat përkatës.
- Me Urdhrin nr. 527, datë 16.10.2024 *“Për hapjen e institucionit arsimor parauniversitar publik, “Shkolla e Bashkuar Gorre, Lushnjë””,* të Minsitrit të Arsimit dhe Sportit, është urdhëruar:
 1. *“Hapja e institucionit arsimor parauniversitar publik, “Shkolla e Bashkur Gorre, Lushnjë”, për shkak të rënies së numrit të nxënësve nën numrin minimal në institucionin arsimor gjimnazin “Pali Dani” dhe shkollën 9-vjeçare “Mihal Davidhi”, Gorre dhe bashkimi i tyre.*
 2. *Ambientet dhe infrastruktura e nevojshme për zhvillimin normal të veprimtarisë së institucionit arsimor parauniversitar publik të sigurohet në bazë të legjislacionit në fuqi, nga Bashkia Lushnjë.*
- Me Urdhrin me nr. 115, datë 25.11.2024, të ZVAP Lushnjë, ka urdhëruar:
 1. *Njoftimin e kryetarëve të Këshillit të Prindërve të secilës klasë (I-XII) për zgjedhjen e Kryetarit të Këshillit të Prindërve për institucionin arsimor “Shkolla e Bashkuar Gorre”.*
 2. *Njoftimin e prindërve, mësuesve dhe nxënësve për zgjedhjen e Bordit të institucionit arsimor “Shkolla e Bashkuar Gorre”.*
 3. *Mbledhja zhvillohet në mjediset e ish-gjimnazit “Pali Dani”, më datë 27.11.2024, ora 13:00.”*
- Urdhri sipërcituar i është përcjellë nëpërmjet e-mailit, znj. L., si drejtuese e shkollës 9-vjeçare “Mihal Davidhi”, Gorre, duke e njoftuar për marrjen e masave për njoftimin e pjesëmarrësve dhe bazës materiale.*(Duke cituar përmbajtjen e e-mailit: “Në zbatim të Urdhrit të MAS, me nr. 527, datë 16.10.2024, për hapjen e iap “Shkolla e Bashkua Gorre”,*

² Cituar në shkresën e përbashkët të ZVAP Lushnjë dhe Bashkisë Lushnjë, të datës 11.07.2024.

³ Me nr. 5762 prot.,

⁴ Me nr. 1147 prot.,

Lushnjë lutem të njoftoni kryetarët e këshillit të prindërve aktual klasa I-XII si dhe mësuesve, anëtarët aktualë të Qeverisë së Nxënësve për zgjedhjen e dy organeve kolegjiale: Bordit të Prindërve dhe Bordit të Shkollës, që të jenë prezent ditën e mërkurë, datë 27.11.2024, ora 13:00, në mjediset e gjimnazit “Pali Dani”.)

Subjekti ankues, nëpërmjet ankesës së saj me nr. 250 regj., datë 04.12.2024, ka pretenduar para Komisionerit se, është diskriminuar nga subjektet: ZVAP Lushnjë dhe Bashkia Lushnjë, përse i takon procedurës së ndjekur për hapjen IAP “Shkolla e Bashkuar Gorre” dhe shpalljes së vendit vakant për drejtues të saj, duke favorizuar drejtuesin aktual të gjimnazit “Pali Dani”, Lushnje.

Komisioneri vëren se, bazuar në kompetencat e sanksionuara nga ligji nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, DRAP Fier ka tagrin për emërimin e drejtorëve të Institucioneve Publike të Arsimit Parauniversitar (IPAP).

Nga ana tjetër, ZVAP Lushnjë ka një rol tejet të veçantë dhe specifik si një hallkë shumë e rëndësishme lidhur me zhvillimin e gjithë procedurës për përzgjedhjen e kandidatëve për pozicionin e drejtorit të IPAP, pavarësisht faktit se nuk është vendimmarrëse. Në mënyrë direkte, e gjithë vendimmarrja e DRAP në përzgjedhjen e drejtorit të IPAP është e bazuar në procedurën e zhvilluar nga ZVAP dhe e kufizuar në përzgjedhjen e dy kandidaturave të klasifikuara me më shumë pikë.

Ligji nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar⁵, në nenin 55 të tij, “Emërimi dhe shkarkimi i drejtorit të institucionit arsimor”, ka përcaktuar se:

“1. Drejtori i institucionit arsimor publik emërohet nga titullari i institucionit arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar përkatës, pas propozimit të dy kandidatëve që vlerësohen me konkurrim të hapur nga komisioni i vlerësimit. Komisioni përbëhet nga një përfaqësues i njësisë së vetëqeverisjes vendore, kryetari i bordit të institucionit, kryetari i këshillit të prindërve të institucionit dhe dy mësues të institucionit arsimor të zgjedhur nga këshilli i mësuesve. Njëri prej dy mësuesve, me përvojën më të gjatë në atë institucion arsimor, drejton komisionin e vlerësimit. Procedurat për emërimin dhe/ose shkarkimin e drejtorit të institucionit përcaktohen me udhëzim të ministrit.

2. Kandidati për drejtor dhe nëndrejtor i institucionit arsimor duhet të ketë, të paktën, kategorinë “Mësues i kualifikuar” dhe të jetë i pajisur me certifikatën e drejtuesit të institucionit arsimor parauniversitar. Certifikimi i kandidatit për drejtor dhe nëndrejtor i institucionit arsimor kryhet pas zhvillimit të trajnimit të detyrueshëm përgatitor në Shkollën e Drejtorëve, për drejtimin e institucionit arsimor. Drejtuesi i institucionit arsimor nuk mund të jetë anëtar i forumeve drejtuese të partive politike”.

⁵ Ndryshuar me ligjin nr. 56/2015 dhe me ligjin nr. 48/2018.

Sipas përcaktimeve të pikës 1, nenit 55, të ligjit nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, procedurat për emërimin dhe/ose shkarkimin e drejtorit të institucionit përcaktohen me udhëzim të ministrit.

Udhëzimi nr. 2, datë 28.01.2020 “Për procedurat e emërimit, pezullimit dhe shkarkimit të drejtorit të institucionit publik të arsimit parauniversitar”, ka përcaktuar në mënyrë të detajuar procedurën që duhet ndjekur për emërimin e drejtorit të IPAP, duke specifikuar edhe detyrat e përgjegjësitë e KVD dhe ZVAP.

Pika A) e këtij Udhëzimi, “Shpallja e vendit për drejtor në institucionin publik të arsimit parauniversitar”, ka përcaktuar se:

“1. Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar (ZVAP), jo më vonë se dhjetë ditë pune nga krijimi i vendit të lirë për drejtor, njofton zyrtarisht Drejtorinë Rajonale të Arsimit Parauniversitar (DRAP) për vendin e lirë të punës.

2. Shpallja e vendit të lirë të punës bëhet nga DRAP jo më vonë se pesë ditë pune nga njoftimi i ZVAP.

3. DRAP shpall vendin e lirë për drejtor të institucionit publik të arsimit parauniversitar (IPAP) në faqen elektronike zyrtare të DRAP dhe të ZVAP, si dhe në këndin e njoftimeve të ZVAP. Shpallja publikohet edhe në këndin e njoftimeve në IPAP, për të cilin bëhet shpallja e vendit të lirë për drejtor.

4. Shpallja e vendit të lirë të punës duhet të përmbajë:

- a) kushtet që duhet të plotësojë kandidati për të aplikuar për vendin e lirë për drejtor të IPAP;*
- b) dokumentacionin, mënyrën dhe afatin e dorëzimit të tij;*
- c) datën e shpalljes së rezultateve të verifikimit paraprak të dokumentacionit;*
- d) afatin e plotësimit të dokumentacionit pas verifikimit paraprak të tij;*
- e) fushat e njohurive dhe aftësitë mbi të cilat do të zhvillohet intervista e strukturuar*
- f) datën e daljes së rezultateve të konkurrimit dhe mënyra e komunikimit të tyre”.*

Pika C⁶) e këtij Udhëzimi, ka përcaktuar se:

“1. Komisioni i shqyrtimit dhe i vlerësimit të dokumentacionit të aplikimit të kandidatëve për pozicionin e drejtorit në IPAP, në vijim Komisioni, ngrihet nga ZVAP;

2. Komisioni përbëhet nga:

- a) kryetari i bordit të IPAP;*
- b) kryetari i këshillit të prindërve të IPAP;*
- c) dy mësues të IPAP të zgjedhur nga këshilli i mësuesve;*

⁶ “Komisioni i shqyrtimit dhe vlerësimit të dokumentacionit të aplikimit të kandidatëve për pozicionin e drejtorit në IPAP”.

d) një përfaqësues i njësisë së vetëqeverisjes vendore.

3. Këshilli i mësuesve të IPAP zgjedh si anëtarë të Komisionit dy mësues, të përzgjedhur me votim të fshehtë, me shumicë të thjeshtë votash;

4. Njëri prej dy mësuesve, me përvojën më të gjatë në atë IPAP, drejton Komisionin;

5. Anëtarët e Komisionit nuk duhet të jenë në konflikt interesi me aplikantin, në kuptim të legjislacionit në fuqi për parandalimin e konfliktit të interesit. Në mbledhjen e parë të Komisionit, anëtarët plotësojnë deklaratën e konfliktit të interesit, sipas shtojcës nr. 3/1, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

6. ZVAP njofton zyrtarisht për kohën dhe vendin e zhvillimit të mbledhjes së Komisionit dhe për pjesëmarrjen në të, të një përfaqësuesi të DPAP/DRAP.

7. Në mbledhjet e Komisionit ftohen të marrin pjesë edhe përfaqësues të sindikatave të mësuesve, të cilat kanë nënshkruar kontratën kolektive me ministrinë përgjegjëse për arsimin, pa të drejtë vote.

8. Komisioni mbledhet në mjediset e IPAP ose të ZVAP, jo më vonë se tri ditë pune pas përfundimit të afatit të dorëzimit të dokumentacionit të aplikimit për drejtor të IPAP dhe kur janë të pranishëm të gjithë anëtarët e tij.

9. Anëtari i Komisionit që mungon, ose që është në konflikt interesi me aplikantin, zëvendësohet. Zëvendësimi kryhet brenda një dite pune nga titullari i njësisë përkatëse të vetëqeverisjes vendore, për anëtarin e zgjedhur prej tij; bordi i IPAP; këshilli i prindërve të IPAP ose këshilli i mësuesve, për anëtarët e zgjedhur prej tyre.

10. Komisioni kryen këto detyra:

a) bën shqyrtimin paraprak të dokumentacionit të paraqitur në dosjen e aplikimit, brenda dy ditëve pune, sipas shtojcave nr. 1 dhe nr. 4, bashkëlidhur këtij udhëzimi;

b) njofton me shkrim/email aplikantët me mungesa në dokumentacion për mangësitë e konstatuara, duke caktuar afat për plotësimin e tyre në tri ditë pune;

c) pas përfundimit të afatit prej pesë ditë pune, liston aplikantët me dokumentacionin e plotë dhe të saktë, të cilët do të vlerësohen nga Komisioni;

d) vlerëson me pikë aplikantët e pranuar, kandidatë për drejtor të IPAP, sipas modelit të përcaktuar në shtojcën nr. 5, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

e) realizon intervistën e strukturuar me secilin kandidat për fushat e njohurive dhe aftësitë për drejtimin e institucionit. Çdo anëtar i Komisionit e vlerëson intervistën me pikë nga 1 në 10;

f) harton tabelat e pikëve dhe rendit kandidatët sipas shumës së përgjithshme të pikëve, në rendin zbritës;

g) brenda tri ditëve pune, shpall në këndin e njoftimeve të IPAP tabelat e pikëve totale të secilit kandidat, sipas shtojcës nr. 6, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

11. Kandidatët kanë në drejtë të paraqesin ankime me shkrim para Komisionit brenda 3 ditëve pune nga shpallja e rezultateve të konkurrimit. Komisioni shqyrton ankesat brenda një dite pune.

12. Kryetari i Komisionit i dorëzon drejtorit të ZVAP dosjet e aplikimit dhe vlerësimin me pikë për dy kandidatët me më shumë pikë. Kopjet e këtyre dokumenteve dhe dosjet e aplikantëve të tjerë ruhen në arkivin e shkollës”.

Pika D⁷) e Udhëzimit, ka përcaktuar se:

- “1. Sektori i Shërbimeve në ZVAP, ose një punonjës i autorizuar nga drejtori i ZVAP, shqyrton dokumentacionin e Komisionit dhe e kthen atë, vetëm nëse konstaton parregullsi të natyrës teknike.
2. Drejtori i ZVAP, brenda dy ditëve pune nga dorëzimi i dokumentacionit të plotë nga Komisioni, përcjell dokumentacionin e dy kandidatëve me më shumë pikë në DRAP.
3. Drejtori i DRAP, brenda pesë ditëve pune nga dorëzimi i dokumentacionit nga ZVAP, interviston dy kandidatët.
4. Intervistat regjistrohen nga sekretari i drejtorit të DRAP dhe arkivohen në DRAP.
5. Brenda tri ditëve pune nga realizimi i intervistës me kandidatët, drejtori i DRAP shpall vendimin për kandidatin fitues për pozicionin e drejtorit të IPAP.
6. Kandidati jofitues, ka të drejtë të paraqesë ankesë në Ministrinë e Arsimit Sportit dhe Rinisë (MASR), brenda tri ditëve pune nga shpallja e kandidatit fitues.
7. MASR shqyrton ankesën dhe jep përgjigjen brenda dhjetë ditëve pune, pas përfundimit të afatit për ankim.
8. Drejtori i DRAP bën emërimin e drejtorit të IPAP. Vendimi i emërimit i komunikohet zyrtarisht ZVAP. ZVAP i dërgon vendimin e emërimit drejtorit të sapo emëruar dhe drejtorit zëvendësues.
9. Drejtori i IPAP nuk duhet të bëjë pjesë, pas emërimit, në forumet drejtuese të partive politike”.

Çdo kandidat i interesuar, i cili pretendon se i është shkelur, mohuar apo cënuar një e drejtë e ligjshme lidhur me vlerësimin e tij gjatë procedurës apo dhe vetë procedurën e ndjekur, mund të ushtrojë të drejtën e ankimit administrativ sipas parashikimeve të Udhëzimit sipërcituar.

Lidhur me sa më sipër, ankuesja, në momentin e depozitimit të ankesës pranë KMD-së (edhe pse i është kërkuar në mënyrë të përsëritur nga KMD, të plotësohet dokumentacioni nëpërmjet e-mailit), nuk ka depozituar asnjë provë a dokument që të faktojë fillimisht, se ka aplikuar për pozicionin e drejtuesit të “Shkollës së Bashkuar Gorre”, shpallur vakant në faqen zyrtare të DRAP Fier, apo që ka plotësuar kërkesat e kriteret e përcaktuara për këtë pozicion drejtues.

Ajo ka pretenduar se po favorizohet drejtuesi i gjimnazit “Jani Dani”, duke sjellë si argument citimin nga ana e ZVAP Lushnjë dhe Bashkisë Lushnjë, në pikën G, të shkresës së tyre të përbashkët ku shkruhet se: “Drejtuesi i insitucionit arsimor, gjimnazit “Pali Dani” plotëson kriteret sipas Udhëzimit nr. 22, datë 13.11.2023”.

Lidhur me këtë citim, Komisioneri vëren se, shkresa në fjalë i drejtohet MAS, dhe jo DRAP Fier, institucion i cili ka për kompetencë dhe zgjedhjen e emërimit të drejtuesit të “Shkollës së Bashkuar

⁷ “Procedura e emërimit të drejtorit të IPAP nga drejtori i DRAP”.

Gorre”, dhe në thelb ka kërkesën për bashkimin e institucioneve arsimore shkollës 9-vjeçare “Mihal Davidhi” Gorre dhe gjimnazit “Pali Jani”, për shkak të rënies së numrit të nxënësve.

Pra, shkresa në fjalë, pavarësisht citimit sipërcituar, nuk ka ndikim në përzgjedhjen e kandidaturës për drejtues të “Shkollës së Bashkuar Gorre”, dhe nga ana tjetër, Komisioneri thekson faktin se, ankuesja nuk provoi se kishte aplikuar e kandiduar për këtë pozicion drejtues, në mënyrë që të vijohej me shqyrtimin e procedurës së ndjekur për përzgjedhjen e emërimin e drejtuesit të “Shkollës së Bashkuar Gorre”; nëse ajo ishte trajtuar në mënyrë të pabarabartë e të pafavorshme krahasuar me kandidatët e tjerë të mundshëm, përfshirë edhe drejtuesin e gjimnazit “Pali Dani”.

Referuar pretendimeve të ankueses dhe dokumentacionit të shqyrtuar, rezulton se deri në momentin e regjistrimit të ankesës së znj. L pranë KMD-së, nuk kemi një procedurë të zhvilluar për këtë pozicion drejtues të “Shkollës së Bashkuar Gorre”, nga ana e ZVAP Lushnjë DRAP Fier, apo një vendimmarrje nga kjo e fundit, dhe pretendimi i ankueses lidhet me paragjykimin e kësaj vendimmarrjeje nga ana e DRAP Fier.

Në këto kushte, Komisioneri vlerëson se, në bazë të rrethanave të shpjeguara, dokumentacionit të depozituar e pretendimit të subjektit ankues, nuk ka informacion të mjaftueshëm apo provë që të dokumentojë faktin se ZVAP Lushnjë dhe DRAP Fier, do të zbatojnë një procedurë të parregullt lidhur me shpalljen e këtij pozicioni vakant apo se do të ketë një vendimmarrje të pabazuar në ligj.

Në këto kushte, KMD, vë në dukje faktin se për shqyrtimin e kësaj ankese nuk ekzistojnë indicie të mjaftueshme për të filluar një procedim administrativ. Në parim, duhet të ekzistojnë fakte dhe prova konkrete që dëshmojnë për trajtim të pabarabartë, si dhe duhet të ketë informacion të mjaftueshëm për të iniciuar një hetim administrativ⁸.

Për sa më sipër, referuar nenit 33/4/ç, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, i cili citon se: “Ankesa nuk pranohet nëse është haptazi e pabazuar ose nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim”, ankesa nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

Në kontekst të legjitimitetit të ankueses kundrejt subjektit të Bashkisë Lushnjë, kundrejt të cilës ka pretenduar diskriminimin lidhur me procedurën për shpalljen e vendit vakant të drejtuesit të “Shkollës së Bashkuar Gorre”, Komisioneri vëren se, bazuar në kompetencat e sanksionuara nga ligji nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, Bashkia Lushnjë, nuk gëzon legjitimitet pasiv në këtë proces, pasi nuk ka tagrin për emërimin e drejtorëve të Institucioneve Publike të Arsimit Parauniversitar (IPAP) dhe as ndonjë rol në procedurën që zhvillohet lidhur me shpalljen e emërimin e tyre (përfshirë edhe ankuesen konkretisht).

⁸ Për analogji citojmë Vendimin nr. 205, datë 22.07.2024, të KMD-së.

Referuar Urdhrit nr. 527, datë 16.10.2024 “Për hapjen e IAP “Shkolla e Bashkuar Gorre” Lushnjë, të MAS-it, kompetencat dhe detyrimi i Bashkisë Lushnjë është vetëm që të sigurojë ambientet dhe infrastrukturën e nevojshme për zhvillimin normal të veprimtarisë së IAP “Shkolla e Bashkuar Gorre” Lushnjë, dhe në asnjë rast ky institucion nuk përfshihet apo ngarkohet me ndonjë rol lidhur me procedurën për shpalljen e emërimit të drejtuesit të IAP-së.

E njëjta logjikë vlen edhe në kontekst të moslegjitimitit të ankueses ndaj drejtuesit të gjmnazit “Jani Dani”, kundrejt të cilit ka pretenduar diskriminimin lidhur me procedurën për shpalljen e vendit vakant të drejtuesit të “Shkollës së Bashkuar Gorre”, pasi Komisioneri vëren se, ai nuk ka asnjë rol në këtë procedurë, dhe për më tepër, të dy ndodhen në të njëjtat kushte (ai dhe ankuesja) pasi janë kandidatë potencialë për të konkuruar për të njëjtin pozicion drejtues.

Për rrjedhojë, referuar nenit 33/4/ç, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ky kërkim i ankueses kundrejt Bashkisë Lushnje nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

Pra, konkludojmë se nuk plotësohen kriteret ligjore të përcaktuara nga ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, për pranimin e ankesës pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 21/1, nenin 32, pika 1/a, si dhe nenin 33, pikat 1, 4/ç, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I:

1. Mospranimin e ankesës të paraqitur nga znj. E. L, pasi është e pabazuar dhe nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONERI

Robert GAJDA